

**PROTOKOLL BASHKËPUNIMI**

**MIDIS**

**TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE  
ANSAMBLIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE**

**OPERËS, FILHARMONISË, BALETIT KOMBËTAR TË  
KOSOVËS DHE ANSAMBLIT KOMBËTAR TË KËNGËVE DHE  
VALLEVE "SHOTA" TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Tiranë, 2021**

Nënshkruesit e këtij protokoll bashkëpunimi, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor të Republikës së Shqipërisë dhe Opera, Filharmonia, Baleti Kombëtar i Kosovës dhe Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota" të Republikës së Kosovës, (referuar si "Palët"), bien dakord për bashkëpunimin artistik dhe shkëmbimin kulturor me anë të këtij Protokoll,

*Duke pasur parasysh*, objektin e veprimtarisë së palëve të këtij protokoll bashkëpunimi,

*Të nxitur*, nga dëshira për të zgjeruar dhe përmirësuar bashkëpunimin artistik, bazuar në interesin e përbashkët dhe me besim të plotë që kjo marrëveshje do të krijojë mundësitë më të mira për teatrin ndërkombëtar, bashkëpunim artistik dhe do të mundësojë një shkëmbim kulturor të kënaqshëm ndërmjet dy vendeve,

*Duke marrë në konsideratë*, forcimin e bashkëpunimit artistik dhe kulturor mes dy institucioneve,

*Duke vlerësuar*, rëndësinë që ky protokoll bashkëpunimi do të sjellë në kuadër të bashkëpunimit midis dy vendeve, bien dakord që:

### **Neni 1**

#### **QËLLIMI**

Qëllimi i këtij protokoll bashkëpunimi është krijimi i kushteve për realizimin e përbashkët të performancave të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor të Republikës së Shqipërisë dhe Operës, Filharmonisë, Baletit Kombëtar të Kosovës dhe Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" të Republikës së Kosovës.

### **Neni 2**

#### **KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR SHKËMBIM SHFAQJESH**

1. Palët informojnë njëra-tjetrën të paktën një (1) vit përpara për realizimin e kalendarit të përbashkët, projekteve, afateve të realizimit të produksioneve, nevojave, programeve artistike, në mënyrë që të kenë mundësi t'i realizojnë dhe përfshijnë në kalendarët respektiv artistik.
2. Format, kohëzgjatja dhe kushtet financiare të shkëmbimit për realizimin e produksioneve artistike do të zbatohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe do të dakordësohen ndërmjet palëve.

### **Neni 3**

#### **FORMAT E BASHKËPUNIMIT**

1. Palët angazhohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë të promovojnë njëra-tjetrën në lidhje me shfaqjet e trupave në festivale apo projekte të tjera teatrore, në kuadër të realizimit të programeve dhe veprimtarive të tyre.
2. Palët marrin pjesë në produksione të përbashkëta të performancave, shkëmbime autorësh, artistësh dhe profesionistësh të ndryshëm dhe në forma të tjera bashkëpunimi në punët e teatrit të cilat janë në interes të dy palëve.
3. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor të Republikës së Shqipërisë do të ofrojë në dispozicion për Operën e Kosovës shfrytëzimin, kopjimin e arkivit dhe nototekës Shqiptare, për të gjitha veprat të cilat nuk kanë të drejtë autori duke njoftuar të paktën 6 muaj përpara, dhe në mbështetje të rregullave dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.
4. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor të Republikës së Shqipërisë do të ofrojë në dispozicion për Operën e Kosovës shfrytëzimin e hapësirave për realizimin e koncerteve premierë ose reprizë, duke njoftuar të paktën 1 vit përpara.
5. Palët angazhohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë për hartimin e Kalendarit të Përbashkët koncertal për datat, ngjarjet apo ditët e shënuara kombëtare si: Festat e Nëntorit, jubiletë e ndryshme kulturore-historike, trashëgimisë dhe figurave të rëndësishme mbarkombëtare
6. Palët angazhohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë për realizimin e shfaqjes "Carmina Burana" në Prishtinë dhe Tiranë
7. Palët angazhohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë për shkëmbimet e autorëve, koncertet e përbashkëta etj.

#### **Neni 4 ZBATIMI I PROTOKOLLIT**

Çdo aktivitet i kryer sipas këtij protokollit, nga cilado nga palët, do të bëhet në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e brendshme të asaj palë.

#### **Neni 5 NDRYSHMI I PROTOKOLLIT**

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen me anë të pëlqimit të ndërsjellë me shkrim nga palët nënshkruese.

#### **Neni 6 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi i këtij Protokollit për Bashkëpunim do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

#### **Neni 7 HYRJA NË FUQI**

1. Ky protokoll bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar.
2. Për zgjidhjen e këtij protokoll bashkëpunimi, njëra nga Palët Nënshkruese njofton palën tjetër me shkrim, të paktën 6 (gjashtë) muaj para.

Nënshkruar në Tiranë më 27 / 11 / 2021 në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të dyja tekstet njëlloj të vlefshëm.

**PËR**

**TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS  
BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

-----  
**DREJTOR**

**ZANA ÇELA**  


**PËR**

**MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

  
-----  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**BISLIM BISLIMI**